



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2023

Lënda: Mbi kërkesën për vënien në dispozicion të dokumentacionit të njësuar me origjinalin dhe informacioneve lidhur me zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit nr. 187, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”

Z. K. S.

Për dajeni: **KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj, të datës 30.11.2023, protokolluar me tonën nr. 6007 prot., datë 1.12.2023, referuar ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë ” keni kërkuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të njësuar me origjinalin dhe informacioneve lidhur me zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit nr. 187, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” ju bëjmë me dije, si më poshtë vijon:

Për pikën e parë, sqarojmë se Komisioni i Ristrukturimit në vijim të Vendimit nr. 2047 prot., datë 21.03.2023, pasi administroi ankesat dhe zhvilloi seancën dëgjimore në datën 07.04.2023, si dhe rimori në shqyrtim dokumentacionin e lidhur me procesin, me Vendimin nr.2452/1 prot., datë 28.04.2023, propozoi transferimin e z. A. A. nga pozicioni Specialist në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, kategoria IV-a në pozicionin Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, kategoria III-b. Departamenti i Administratës Publike në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të Kreut II, të Vendimit nr.125, datë 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, të Udhëzimit nr. 1, datë 1.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo rristrukurimit”, të ndryshuar, pas shqyrtimit të propozimit të Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me aktin nr. 1723/166 prot., datë 17.05.2023 vendosi transferimin e z. A. A. në pozicionin Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, kategoria III-b. Referuar nenit 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 17, pika 2, gërma dh), të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, nuk mund t’ju

vendosim në dispozicion Vendimin e Komisionit të Ristrukturimit dhe Vendimin e DAP për z. A. A.

Për pikën e dytë. Referuar Urdhrit nr. 187, datë 15.11.2022 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Komisioni i Ristrukturimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me Vendimin nr. 2047 prot., datë 21.03.2023, propozoi transferimin e z. E. K. nga pozicioni Inspektor në Sektorin e Monitorimit, në Drejtorinë e Inspektim Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, kategoria e pagës III-b, në pozicionin Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave), në Drejtorinë e Inspektim Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit kategoria III-b. Departamenti i Administratës Publike në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të Kreut II, të Vendimit nr.125, datë 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, të Udhëzimit nr. 1, datë 1.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, të ndryshuar, pas shqyrtimit të propozimit të Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në cilësinë e njësisë përgjegjëse me aktin nr. 1723/74 prot., datë 24.03.2023 vendosi transferimin e z. E. K. në pozicionin Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave), në Drejtorinë e Inspektim Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit kategoria III-b.

DAP nuk mund t’ju vendosi në dispozicion Vendimin Nr.1723/74 datë 24.03.2023 të Departamentit të Administratës Publike me lëndë “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit të institucionit të punonjësit z. E. K., pasi ky akt është akt individual dhe si i tillë bazuar në nenin 17, pika 2, gërma dh), të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar“ Kufizimi i të drejtës për informim *E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm*” barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.”

Për pikat 3,4, 5 dhe 6 ju informojmë se, procesi i ristrukturimit në AKM rezulton të ketë përfunduar në datën 24.03.2023. Në përfundim të procesit të ristrukturimit ka qenë vakant vetëm një pozicionin Inspektor në Sektorin e Ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve) në AKM kategori III-b. Ndërkohë, në Sektorin e Inspektimit Mjedisor është pozicioni vakant krijuar në datë 05.04.2023, për shkak të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil referuar gërmës “c”, të nenit 65, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të një nëpunës civil.

Lidhur me kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për procedurë lëvizjes paralele, sqarojmë se , ato janë të përcaktuara në pikën 2, të kreut VII, të Vendimit nr.243 , datë 18.03.2015 “ Për pranimin lëvizjen paralele,periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar. Ndërkohë, kushtet që duhet të plotësojë kandidatët për pranim në shërbimin civil janë të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr.152/2013 ‘Për nëpunësin civil’, i ndryshuar .

Përsa i përket kërkesave të posaçme, ju bëjmë me dije se, ato janë të përcaktuara në përshkrimin e punës të miratuar sipas VKM nr.142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Kërkesat e posaçme për pozicionin Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor në Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit, me kategori page III-b , referuar përshkrimin të miratuar janë si vijon:

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Profesional" në Shkenca Mjedisore/Shkenca Natyrore/Shkenca Inxhinierike/Shkenca Juridike/Shkenca Ekonomike/Shkenca Bujqësore. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b - Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.

Kërkesat e posaçme për pozicionin Inspektor në Sektorin e Ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve) në AKM kategori III-b, referuar përshkrimin të miratuar janë si vijon:

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Profesional" në Shkenca Mjedisore/Shkenca Natyrore/ Shkenca Inxhinierike/Shkenca Juridike/Shkenca Ekonomike/Shkenca Bujqësore. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b - Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.

Për pikën e tetë, nëse është zbatuar sistemi i pikëzimit sipas Aneksit nr.1, të Udhëzimit të DAP, nr1, datë 1.03.2016. i ndryshuar, për rastin tuaj, Departamenti i Administratës Publike, ju bën me dije se ju ka dhënë përgjigje me shkresën nr. 1723/140 prot., datë 20.04.2023 .

Për pikat 7,9. 10 dhe 11, ju bëjmë me dije se informacioni që kërkoni administrohet pranë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ku është ngritur Komisioni i Ristrukturimit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

